

Hapet thirrja për aplikime për studentët e doktoraturës në Universitetin Hungarez të Shkencave Sportive, në kuadër të programit Erasmus+ për Shkollë Verore

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për 3 (tre) bursa për mobilitete për studentët e ciklit të tretë të studimeve pranë Universitetit Hungarez të Shkencave Sportive për vitin akademik 2024-2025 në kuadër të organizimit të Shkollës Verore për Fiziologjisë së Ushtrimit që organizohet në datat **21-25 qershor 2025** në Budapest, Hungari.

<https://international.tf.hu/summer-school/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve PhD për trajnim;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Doktoraturë;

Studentët aplikues duhet të plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë studentë të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve të Universiteti i Sporteve të Tiranës.
2. Të jenë punonjës me kontratë të plotë punësimi;
3. Të kenë njohje të gjuhës angleze të certifikuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Kohëzgjatja e bursave:

- deri në 1 (një) javë

Fushat e shkëmbimit:

Bursat/mobilitetet,do të jenë në fushat si vijon:

- Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti
- Shkencat Sportive

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin prej 70 euro/dita;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);
- Dieta (nga buxheti UST)

Për të përcaktuar distancën ju lutem referojuni link-ut:

<https://erasmus-plus.ec.europa.eu/resources-and-tools/distance-calculator>

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e ciklit të tretë:

- CV në gjuhën angleze (formati EUROPASS);
- Fotokopje e pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Letër motivivimi në gjuhën angleze, ku specifikohet arsyeja e deshirës për të marrë pjesë në këtë mobilitet dhe se si konkretisht ky mobilitet do të ndihmojë kerkimin e kandidatit;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj (anglisht);
- Letër rekomandimi nga drejtuesi i tezës (shqip/anglisht);

Afati për aplikim: 26 maj 2025

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi deri më **26 maj 2025**, pranë Zyrës së Protokollit në UST dhe të dërgohen të skanuara në adresën e-mailin erasmus@ust.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat e mobiliteteve mund të na kontaktoni në adresën: erasmus@ust.edu.al

Universiteti i Sporteve të Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!